



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF  
SUHAREKA

11-02-2019

| REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS<br>REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUHAREKA<br>REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY OF SUHAREKA |                         |                                |                            |
|--|-------------------------|--------------------------------|----------------------------|
| MAJRRË NË DORËZIM  | PRËMIRJE                | PROJEKTI                       | PROJEKTI                   |
| Nësa org.<br>Org. Jedinica<br>Org. Unit  | Numri<br>Braj<br>Number | Shprehja<br>Prilog<br>Appendix | Vlera<br>Vrednost<br>Value |
| 11   | 016                     | 10788                          | -                          |

Komisioni Komunal për zhvillimin e procedurave dhe shqyrtimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtë dhe afatgjatë të pronës komunale

11.02.2019

Duke u bazuar në nenin 9 të ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajshme të komunës ,neni 15 paragrafi 2 të rregullores QRK nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajshme të Komunës, komisioni në përberje prej Emrush Bytyçi kryesues , Sanie Kuqi ,Marigona Gashi, Besa Kuqi, Antigona Kolgeci, Xhemajl Kabashaj, dhe Driton Maliqaj anëtar , në çështjen juridike vlerësimin e ofertave në konkurimin e hapur Nr.02/2018 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të parces në ZI Shirokë në mbledhjen e mbajtur me datën 08.02.2019 në seancën jo publike gjatë shqyrtimit komisioni njëzëri vendosi që të nxjerr këtë vendim dhe atë duke u bazuar në nenin 44, lidhur me nenin 48, tëLigjit Nr-05/L-031, për Procedurën e përgjithshme Administrative:

### VENDIM

- I. **ANULOHET** – konkurimi i hapur Nr.2/2018 i datës :19.11.2018 me Nr.protokolli 11Nr.463-73602 për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajshme të komunës pas shqyrtimit të vendimit 01Nr.016-7958 të datës 31.01.2019. Për parcelën kadastrale Nr.2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ “depo ndertimore” pasuri shoqërore në emër të ”Komuna e Suharekës”.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### ARSYETIM

Komuna e Suharekës përkatësisht komisioni për zhvillimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë dhe afatshkurtë të pronës së paluajshme komunale ka bërë shpalljen e konkurimit të hapur Nr.2/2018 të datës: 19.11.2018 me Nr. protokolli 11-463-73602 për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajshme të komunës për parcelën kadastrale Nr.2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m<sup>2</sup>, sipas planit rregullativ “depo ndertimore” pasuri shoqërore në emër të ”Komuna e Suharekës”.

Në këtë konkurim kanë konkuruar gjithsej dy operatorë ekonomik:

“Graniti” sh.p.kme përfaqësues Bedri Lumi me seli në Suharekë, dhe “Seti Commerc” me përfaqësues Nysret Bajraktari me seli në Suharekë.

Komisioni I lartëcekur me date 10.01.2019 ka bërë hapjen e ofertave ku present kanë qenë edhe ofertuesit e të dy ndërmarrjeve të lartcekura, ndërsa me datë 15.01.2019 komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar nga OE kan marrë vendimin 01Nr.016-4191 për Anulimin e Konkurimit të Hapur 02/2018.

Operatori ekonomik “Seti Commerc” ka atakuar vendimin e Komisionit për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale për mes ankesës 01Nr.615-5909 datë 23.01.2019.

Komisioni për shqyrtimin e Ankesave ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka marrë vendimin 01Nr.016-7958 të datës 31.01.2019, ku ka aprovuar ankesën e “SetiComerc”, ka shfuqizuar vendimin 01Nr.016-4191 të datës 15.01.2019 dhe ka obliguar komisionin për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, që në afatet ligjore që janë të parapar në Ligjin Nr.04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012” dhe të Rregullores (QRK) Nr.-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, nga dita e pranimit të vendimit të bën rishqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të ofertuesve.

Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, në seancën e mbajtur me datë 08.02.2019 ka shqyrtuar vendimin e komisionit të ankesave, ka bërë rishqyrtimin e ofertave të ofertuesve dhe në bazë të dispozitave ligjore njëzëri vendosi që këtë procedure të konkurimit të hapur ta anulojë dhe për të njëjtën të fillojë procesi i ri-konkurimit të hapur .

**Këshillë juridike:** kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të bëjë ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetëditë) nga dita e pranimit të këtij vendimi në komisionin e ankesave të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

Kryesuesi i komisionit:



Emrush BYTYÇI

